

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RETAIL PARK SH.P.K.
ME SELI NË : GODINA BRUNES SPACE, KATI I 2-TE, PRANE QENDRA TREGTARE TEG, PERBALLE HYRJES
VJOLE RRUGA NACIONALE TIRANE-ELBASAN, FARKE, LUNDER,TIRANE
NIPT L71515042Q

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më **28.12.2022 (dy mijë e njëzet e dy)**, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë **“Retail Park” Sh.p.k.**, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në **“Godina Brunos Space, Kati I 2-Te, Prane Qendra Tregtare TEG, Perballe Hyrjes Vjole Rruga Nationale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder,Tirane”**, (më tej referuar si **“Shoqëria”**), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

“Balfin-Balkan Finance Investment Group” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, - e cila zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin-Balkan Finance Investment Group (**“Ortaku i Vetëm”**).

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”** dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË RETAIL PARK SH.P.K.;**
- II. TE TJERA;**

Duke kaluar në diskutimin e çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej **37,012,694 LEK (tridhjetë e shtatë milion e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër lekë)**. Financimi do të jepet në formën e kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme prej 37,012,694 LEK (tridhjetë e shtatë milion e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër lekë) në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 289.598.646,05 LEK (dyqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë zero presje pesë lekë) **do të zmadhohet në 326,611,340.05 LEK (dyqind e njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet pikë zero presje pesë lekë)**.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:


VENDOSI


- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q) me **37,012,694 LEK (tridhjetë e shtatë milion e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit")**;
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nënshkruhet dhe është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetem në para, nga **23 Gusht 2022 deri ne 09 Dhjetor 2022.**
- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 289.598.646,05 LEK (dyqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë zero presje pesë lekë) do të bëhet **326,611,340.05 LEK (dyqind e njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet pikë zero presje pesë lekë).**
- D. Të autorizojë përdorimin e kapitalit të injektuar për investime të parashikuara nga Shoqëria.
- E. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
RETAIL PARK SH.P.K.**

KRYETAR


ZNJ. EDLIRA MUKA


KALFIN Sh.p.k.
Rruga "Papa Gjon Pali 4"
ABA Business Center, Kat 11, Tiranë
Nipë: K72223031K

SEKRETAR


ZNJ. EVA VEIZAJ